



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 08.10.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Albulena Balaj-Halimaj, Driton Çausi, Abdyl Salihu dhe Arbërie Nagavci.

**Munguan:** Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Mufera Shinik.

**Përfaqësues të tjerë:** Fadil Beka – deputet, Betim Jahaj - MKRS, KDI dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.9.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-093 për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport;**

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-117 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore;
7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive;
8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë;
9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;
11. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për Anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
12. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

#### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.09.2018**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 20.09.2018, u miratua pa vërejtje.

#### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-093 për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së**

**Ismajl Kurteshi**, lidhur me këtë projektligj, tha se nuk është definuar fjala vlerë dhe çka nënkuptohet me këtë fjalë. Ai gjithashtu tha se nuk është e ditur se cili institucion i mbron këto vlera të luftës dhe që nuk është e qartë pse është veçuar vetëm Drejtoria Politike në këtë projektligj. Ai tha se deputetët në mes të dy leximeve do të kenë mundësi të afrojnë sugjerimet e tyre lidhur me këtë projektligj.

**Fadil Beka**, propozues i nismës legislative, tha se iniciativa ligjore ka ardhur prej kryetarit të Kuvendit dhe 25 deputetë të tjerë që e kanë mbështetur këtë projektligj. Ai tha se ky projektligj është hartuar konform Kushtetutës, nenit 79, gjegjësisht konform nenit 53 të Rregullores së Kuvendit. Ai tha se ky projektligj përcakton masat lidhur me vlerat e luftës së UÇK-së, të cilët me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë së popullit të Kosovës. Gjithashtu ai tha se ky projektligj përcakton edhe

obligimin institucional dhe qytetar për mbrojtjen e vlerave të luftës dhe që në objektiva është përcaktuar se çka konsiderohet si vlerë e mbrojtur. Ai tha se kur flitet për Drejtorinë Politike, nuk flitet për mbrojtjen e ndonjë individi në veçanti por për mbrojtjen e institucionit sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë një formacion i armatosur me hierarki ushtarake që është udhëhequr nga Drejtoria Politike.

**Teuta Haxhiu** tha edhe pse është një projektligj i vonuar dhe me hapësira për ndërhyrje, ajo afron përkrahjen e saj duke afruar sugjerimet e nevojshme për këtë projektligj. Ajo tha se është e interesuar që ky ligj të jetë i kompletuar dhe i zbatueshëm.

**Arbërie Nagavci** tha se projektligji është shumë i nevojshëm dhe që duhet përkrahur. Ajo tha se edhe pse është e përcaktuar në objektiva kush është vlerë e luftës, mungon definimi i saktë i vlerave, caktimi i një institucioni për ruajtjen e këtyre vlerave, çka nënkuptohet me dëmtim të një vlere të caktuar, dëmtimi fizik apo edhe shprehja verbale kundër këtyre vlerave, të definohet autoriteti për ruajtjen e këtyre vlerave dhe mënyrën se si do t' i ruajë. Ajo gjithashtu tha se nuk janë të përcaktuara as sanksionet për cenimin apo shkeljen e këtyre vlerave dhe kërkoi sqarim për specifikimin e vetëm një drejtorie, asaj politike, e jo edhe drejtorive tjera, duke marrë parasysh faktin që ka pasur edhe drejtori të tjera. Në anën tjetër, ajo shtoi që është e rëndësishme të përmendet që ky ligj është iniciuar edhe më parë nga po të njëjtit njerëz, që njëherë e kanë përkrah Gjykatën Speciale dhe që pastaj në Dhjetor të vitit të kaluar tentuan të votonin kundër kësaj Gjykate, e që flet për poenë politike. Bazuar në këtë, ajo tha se duhet pasur shumë kujdes që të hartohet një ligj që të vetmin qëllim ka mbrojtjen e vlerave të luftës, e jo fitimin e poenëve politik.

**Driton Çausi** tha se nuk ka asnjë dyshim për motivet e një ligji të tillë. Ai tha se është e rëndësishme një formalizim i vazhdueshëm në rritje i vlerave të luftës, të pakontestueshme, mirëpo që ka ecur paralelisht me një degradim të trajtimit të këtyre vlerave nga institucionet dhe nga elita politike vendimmarrëse në Republikën e Kosovës. Ai tha se rasti i listave të veteranëve e shpërfaq më së miri këtë fenomen dhe që miratimi i këtij ligji nuk siguron që kjo kategori do të trajtohet ndryshe nga shoqëria apo vendimmarrësit, nëse iniciativa ose vullneti i pushtetit nuk ekziston për këtë, që përkundrazi ka punuar në rrenim të këtyre vlerave. Në anën tjetër ai kërkoi sqarime të neni 6, i cili thotë se në rast të ndaljes ose arrestimit të veteranit të UÇK-së sipas fletë arresteve ndërkombëtare të lëshuara nga Serbia me motive politike, Qeveria e Republikës së Kosovës ndërmerr veprimet e nevojshme për mbrojtjen e veteranit. Ai tha se është shumë i paqartë termi veprime të nevojshme duke marrë parasysh që ka pasur raste kur janë arrestuar persona nga këto fletarreste dhe ka munguar veprimi i institucioneve tona sikundër përgjigje.

**Valentina Bunjaku - Rexhepi**, shtroi pyetjen se a janë të përfshirë të gjithë ushtarët pasi që në atë kohë ka ekzistuar edhe FARK-u, gjithashtu për Drejtorinë Politike, ku disa prej tyre edhe sot janë politikanë që janë duke e shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kërkoi sqarime se si mbrohen këta individë.

**Fadil Beka** tha se me anë të këtij ligji nuk mbrohen individët por institucionet dhe se ka ekzistuar vetëm një formacion ushtarak, UÇK-ja që ka pasur emblemën dhe uniformen sepse edhe FARK-u ka pasur emblemën dhe uniformen e UÇK-së. Ai tha se është e qartë ky projektligj ka vend për plotësim, mirëpo Qeveria duhet t' i përdorë vetë mekanizmat, qoftë diplomatik, qoftë me zyrën ndërlidhëse. Qeveria është e obliguar brenda 5 ditëve të ftojë Kuvendin se çfarë veprimesh ka ndërmarrë për një rast të arrestimit të ndonjë veterani të UÇK-së. Në anën tjetër ai tha se shembulli është marrë nga modeli kroat dhe mekanizmi mbrojtës është ligji në fuqi.

**Ismajl Kurteshi** falënderoi deputetin për kontributin e tij. Ai ftoi anëtarët e komisionit të votojnë për dërgimin e projektligjit për lexim të parë në Kuvendin e RKS.

Pas diskutimeve, komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

### R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-093 për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport**

**Ismajl Kurteshi** tha se projektligjet e proceduara nga MKRS kanë për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve bazike me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Kundërvajtje.

**Betim Jahaj**, përfaqësues i MKRS, tha se qëllimi i këtij projektligji dhe projektligjeve të tjera të cilat janë paraparë për shqyrtim është harmonizimi me ligjin për kundërvajtje, për sa i përket sanksioneve.

**Driton Çausi**, lidhur me këtë projektligj, parashtroi vërejtjet e tij te neni 17 për sanksionimin e personave që marrin preparate të ndaluara apo që janë të dënueshme, ku dënimi është 500-2000 euro. Ai tha se në vendet e tjera, përkatësisht në Gjermani, dënimi për një veprim të tillë është 8 deri në 10 vjet burgim. Ai tha se ky dënim është i pamjaftueshëm dhe mund të shihet edhe si stimulim për mundësinë e përdorimit të këtyre stimuljve për rritjen e rezultateve. Ai tha se vlera e vogël e dënimit vlen edhe për dy nene të tjera, nenin 77, ata që detyrojnë sportistët të stërviten edhe kur kanë mangësi fizike apo sëmundje dhe neni tjetër për ata që organizojnë ngjarjen sportive, mirëpo që nuk sigurojnë ndihmën e shpejtë ose masat tjera mbrojtëse.

**Teuta Haxhiu** tha se këto projektligje do të shqyrtohen në veçanti dhe që është e nevojshme të harmonizohen me ligjin për kundërvajtje. Ajo tha se është e rëndësishme që këto ligje të jenë të zbatueshme.

**Valentina Bunjaku - Rexhepi** tha se ky projektligj është më i kompletuar si projektligji i diskutuar më parë. Ajo gjithashtu tha se te neni 17, paragrafi 1, dënimet duhen të rriten prej 5000 deri në 10.000 euro gjombë për ata që përdorin mjete të dëmshme për shëndetin e pjesëmarrësve të tjerë në lojë.

Pas diskutimeve, Komisioni me 6 vota për dhe 1 votë abstenim vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport.

#### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit**

**Ismajl Kurteshi** e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

**Arbërie Nagavci** kërkoi sqarim nga përfaqësuesi i ministrisë për zvogëlimin e të gjitha gjobave, përveç gjobave të projektligji për biblioteka ku janë rritur gjobat.

**Betim Jahaj** tha se iniciativa për harmonizim ligjor ka ardhur si obligim ligjor prej Qeverisë së Kosovës kur është hartuar ligji për kundërvajtje, ku është paraparë mbrojtja e librit. Ai tha se për shkak të mos plotësimit të detyrimit, dikasteret përkatës kanë sugjeruar rritje të gjobave. Ndërsa sa i përket zvogëlimit të gjobave të tjera, është për shkak të harmonizimit me ligjin për kundërvajtje që nuk lejon që gjoba për një person fizik të jetë më shumë se 2000 euro, gjobë e cila eventualisht mund të dyfishohet.

Pas diskutimeve, komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

#### **6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-117 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturor**

**Ismajl Kurteshi** e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

Komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

#### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-117 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë.

**7. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive**

**Ismajl Kurteshi** e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

Komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

**R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

**8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë**

**Ismajl Kurteshi** e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

**Betim Jahaj, MKRS**, tha se për dallim nga projektligjet e tjera, ky projektligj ka qenë edhe njëherë në Kuvendin për plotësim/ndryshim. Ai tha se ministria është në fazën e krijimit të grupit punues për plotësim/ndryshim dhe që ministria do të jetë e gatshme të dorëzojë këtë ligj brenda afateve të caktuara.

**Arbërie Nagavci** tha se është shumë e rëndësishme që ligji të mundësojë çështjen e ruajtjes së destinacionit dhe që qartë të ndalojë ndryshimin e destinacionit të kinemave.

**Albulena Balaj- Halimaj**, përgëzoi ministrinë për iniciativën e harmonizimit të ligjeve, sepse asnjë ligj në Kosovë nuk është i harmonizuar me tjetrin.

Komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

**R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë.

**9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta**

**Ismajl Kurteshi** e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

Komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

## **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

### **10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat**

**Ismajl Kurteshi**, e hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e projektligjit dhe i ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen lidhur me këtë projektligj.

**Valentina Bunjaku - Rexhepi**, lidhur me këtë projektligj, tha se do të ishte mirë që të ulen gjobat për bibliotekat krahasuar me gjobat te projektligjet e tjera.

Komisioni me vota unanime vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë

## **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat.

### **11. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për Anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

**Ismajl Kurteshi** tha se Komisioni ka shqyrtuar listën me kandidatët për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Komisioni ka ftuar në intervistë kandidatët që i kanë plotësuar kushtet formale sipas konkursit. Pas intervistimit të kandidatëve Komisioni ka bërë përzgjedhjen bazuar në poentimin nga intervista. Komisioni i propozon Kuvendit për emërim listën me shtatë kandidatë si vijon: Zanita Halimi, Premtim Alaj, Arjeta Miftari, Arsim Mehmeti, Muhamet Qerimi, Bego Kululleri dhe Filjko Jovanoviq, ku dy të fundit i përfaqësojnë komunitetet. Ai sqaroi që për komunitetin turk, ka aplikuar vetëm Bego Kululleri dhe nuk ka pasur kundër kandidatë.

**Driton Çausi** shprehu pakënaqësinë e tij me mënyrën se si ka shkuar kjo përzgjedhje dhe tha se shpreson që zgjedhjet e ardhshme që i takojnë komisionit të jenë më mirë të organizuara dhe më të drejta për kandidatë. Ai theksoi që edhe pse nuk e kishte pasur përkrahjen e komisionit, e drejtë do të ishte të dërgoheshin 10 emra për votim sepse do të ishte më objektive dhe do të njihej autonomia e secilit deputet.

**Arbërie Nagavci**, gjithashtu, shprehu pakënaqësinë e saj për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve. Ajo tha se iu është mohuar e drejta për të qenë pjesë e këtij Këshilli të rëndësishëm kandidatëve që kanë pasur kualifikim dhe që kanë më të përgjegjshëm për këtë pozitë. Po ashtu,

ajo tha se ndihet e pakënaqur me faktin që janë vetëm 5 emra që do të shkojnë në Kuvend kur marrëveshja në fillim ka qenë të dërgohen 10 emra.

**Valentina Bunjaku - Rexhepi** tha se komisioni bashkërisht ka votuar kandidatet dhe në fund ka vendosur që të propozojë listën me shtatë kandidatë.

**Ismajl Kurteshi** tha se Komisioni ka vepruar ashtu siç ka menduar që është më së miri. Ai theksoi që kandidatët e propozuar kanë më së shumti vota. Gjithashtu, ai tha se shqetësimet që deputetët i shprehën këtu, t'i shprehin edhe në Kuvend.

**Teuta Haxhiu** tha se vendimet e Komisionit janë të ditura pasi që e ka votuar listën. Ajo tha se komisionit i mbetet vetëm me e dërguar në seancë dhe asgjë tjetër.

**Driton Çausi** tha se nuk po kontestohen vendimet e komisionit. Ai tha se nuk është objektive që të behet rivlerësim i 25 kandidatëve 1 muaj e gjysmë pasi është përfunduar intervistimi dhe që është dashur që secili anëtar të sjellë pikët e tij pa komunikuar.

**Ismajl Kurteshi** ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen me votë për procedimin e listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore.

Komisioni me 3 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë abstenim, Kuvendit ia paraqet këtë:

### **R e k o m a n d i m**

I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

### **12. Të ndryshme**

**Ismajl Kurteshi** tha se në mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Arsimit për të raportuar para komisionit për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Gjithashtu propozoi që në njërën nga mbledhjet e ardhshme të ftohen përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, për të diskutuar lidhur me punën e Akademisë.

**Albulena Balaj - Halimaj**, i bëri thirrje kryetarit të komisionit që të mos lejojë që pjesëmarrësit në komision të ofendojnë deputetët.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetari i komisionit,**

-----  
**Ismajl Kurteshi**